



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 56

Datë: 27. 10. 2017, ora: 14:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP; Përkthyes: Vera Dula

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
- *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr.54 dhe 55 /2017;*
 2. Raport nga Sekretariati (raport nga QNR-ja);
 3. Të ndryshme
-

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr.54 dhe 55 /2017

Valdete Daka: Atëherë po fillojmë mbledhjen e 56 të KQZ-së. Rendi i ditës, i kemi tri pika. Kush është për këtë rend dite?

Anëtarët e KQZ miratuan rendin e ditës.

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr.54 dhe 55 /2017

Në vazhdim të mbledhjes, anëtarët e KQZ shqyrtuan procesverbale nga mbledhjet e KQZ-së nr.54 dhe 55 /2017.

Valdete Daka: Fillojmë me pikën e parë, procesverbali 54 dhe 55. A ka dikush vërejtje...? Nëse nuk ka, kush është për...?

Anëtarët e KQZ miratuan procesverbalet e KQZ-së nr.54 dhe 55 /2017

2. Raport nga Sekretariati (raport nga QNR-ja)

Burim Ahmetaj: Të nderuar anëtar të KQZ-së: Qendra e Numërimit të Rezultateve ka proceduar 98.68% formularët e rezultateve për Kryetar të komunave. 73.01% FPR për kryetar të Kuvendit Komunal. Formularët për kandidatëve janë 44.35%, dhe listat përfundimtare e votuesve janë 98.32%. E keni edhe para jush edhe një raport të reduktimit të vendvotimeve të cilat nuk kanë mundur të auditorët, formularët e rezultateve për kryetar komune. Pra, janë gjithsej 22 vendvotime të cilat kanë përfunduar në auditiv për shkak të mos përputhjeve të fletëvotimeve dhe është dashur të fillohet në bazë të procedurave të QNR-së. Nga raporti i hetimit del se, 8 vendvotime edhe pas hetimit nuk kanë mundur të rekomandohen të procedohen si të rregullta, pra natyra e mos përputhjes është se ka mos përputhje mes fletëvotimeve të pranuar të përdorura dhe të pa përdorura ka raste ku ka dallime mes nënshkrimeve në listë përfundimtare të votuesve dhe rubrikave 5 dhe 8 në formular të rezultateve, ka raste ku ka gabim në plotësimin e formularëve të rezultateve dhe ka edhe raste që ka mos shpërndarje të votave të kandidatëve për kryetar komune. Këto janë ato rastet të cilat janë brenda 8 vendvotimeve të cilat rekomandohet që KQZ-ja për arsye se nuk mundën të kalojnë auditimin rekomandohet KQZ-ja që vendvotimet 0205C/08R, 0818C/01R, 1102X/12R, 1716C/022, 1942E/012, 2003A/02R, 2007A/062, 2038A/022 nuk kanë përputhje dhe rekomandohet KQZ-ja që këto 8 vendvotime të rinumërohen, përndryshe vendvotimet e tjera rekomandohet që të procedohen të rregullta. Bashkangjitur këtij raporti e keni, raportin e Qendrës së Numërimit, raportin nga vendvotimet për auditim, raportin e progresit të futjes së të dhënave dhe raportin e rinumërimeve që kanë qenë të rinumëruara nga karantina raportet i keni të bashkangjitura në këtë raport bashkë me dy rekomandime që rekomandimi i parë, 8 vendvotime të rinumërohen dhe vendvotimet e tjera të procedohen si të rregullta. Vëzhgues të pranishëm në qendër të rezultateve 13 kanë qenë gjithsej 19 vëzhgues kështu që gjitha proceset janë duke u zhvilluar në prani të vëzhguesve, kaq sa i përket raportit nga QNR-ja bashkë me rekomandimet.

Valdete Daka: Faleminderit Burim. A ka dikush pyetje për Burimin lidhur me këto dy vendvotime lidhur me rekomandimin. Po, urdhëro Adnan...!

Adnan Rrustemi: Faleminderit. Në radhë të parë, po e theksoj..., e di që është edhe pjesë e punës por, duhet me i njoftuar subjektet politike dhe vëzhguesit sa herë që ndodh një vendim për rinumërim të caktuara në mënyrë që ata të jenë në dijeni, ta shfrytëzojnë të drejtën për ta

monitoruar procesin e rinumërimit. E dyta, për rinumërimet e djeshëm, nëse është e mundur me angazhuar dikë nga stafi për anëtar të KQZ-së, siç e thash, para se gjithash, formularët që dalin nga rinumërimi të skanohen dhe të na dërgohen në e-mail sa më parë, mundësisht pasi të bëhet rinumërimi ngase, nuk janë shumë vendvotime. Besoj, brenda ditës, dhe e di që kjo është e mundur! Po e zë, për raportin e mbrëmshëm, ende si kemi rezultatet nga rinumërimi sikurse, nuk i kemi edhe formularët nga rinumërimi i votave me postë. E treta, kam pyetje për këto vendvotime. Keni rekomanduar m'u trajtuar si të rregullta dhe në arsyetim keni thënë se nuk janë shënuar fletëvotimet në rubrika përkatëse. Ajo që po më intereson është se, si keni arritur me i përmirësuar, a duke i nxjerrë nga kopja e formularit, kopja e punës sepse në fakt, pa rinumërim fare keni ardhur në përfundim...?

Burim Ahmetaj: Po ja filloj prej kësaj të fundit. Sipas procedurave të QNR-së merret dhe hetohet kutia e votimit. Pra sa të numërohen sa fletëvotime janë gjithsej të vlefshme, pa vlefshme, të zbrastë dhe të përdorura, të gjitha pastaj numërohen. Ka pasur ngatërrim rubrikash pa u shikuar. Subjektet numërohen dhe shënohen afër atyre rubrikave, shënohen me ngjyrë të kuqe dhe ndryshimet që do të bëhen d.m.th., asgjë nuk preket prej origjinalit, dhe shënohet afër rubrikave, dhe shënohen afër procedurave të dallimit me të dhënat e reja në bazë të procedurave. Rezultati nuk preket. Dhe nuk ka pas gabime se, me pas gabime në rezultat, është dashur me e lajmëruar komisionin ngase, nuk kemi të drejt me prekë në rezultat. Fletëvotimet dhe ngatërrimet e rubrikave mundë ti përmirësojmë në bazë të procedurave të QNR-së, aty, d.m.th., prej gjendjes faktike. Sa i parkete atyre skanimeve, e pashë se në ueb faqe janë të publikuara dhe të rinumëruar të djeshmet...! Ndërsa, sa u përket vëzhguesve...Para çdo procesi, i thërrasim dhe nëse është nevoja i presim 1 orë, deri sa të na konfirmojnë...Sidomos për rinumërimet...! Nuk fillon asnjë proces pa qenë të pranishëm vëzhguesit.

Ilir Gashi: Ne, e dimë se jemi duke u përballur edhe me ankesat e shumta të kandidateve për Këshilltar Komunal. Dhe njëra nga vërejtjet që është duke u dhanë lidhet me atë se makina kërkuese nuk po funksionon. Krye shefi, mundet me na dhanë shpjegim... Dhe ata po duan me ditë për Vendvotime se, ku kanë votuar njerëzit. Pastaj, ankesa kur duan me i përpilua, atëherë njerëzit duan që të mund të dëshmojnë se çka ka ndodh në një vendvotim. Ata, e kanë problem edhe veten me gjet se ku ka votuar në klasë në bazë të alfabetit...Është mirë që urgjentisht me ndërhy që ajo me u bërë funksionale në mënyrë që, me ju hy në punë të gjithë atyre që janë të interesuar...E dyta, ndoshta janë disa formularë që janë skanuar edhe publikuar qysh janë marr nga vendvotimet si bazë edhe për ankimin nga kandidatët. Por, ka ankesa se po të njëjtën kohë, janë përmirësuar dhe janë skanuar formularë të ri, do të thotë nuk figuron më i njëjti formularë. Po dua me ditë që formularët nuk janë përzier, por ka edhe kësi lloj dyshimesh...! Ashtu siç tha edhe kolegu, është mirë me na informuar në kohë reale për gjithë procesin që po ndodh, sidomos për procesin e rinumërimit. Ndërsa, sa u parkete vëzhguesve, është mirë që me kohë me i informua të subjekteve politike, ndonëse edhe ne e bëjmë, por është mirë që subjektet politike me qenë të informuar edhe nga QNR dhe që çdo gjë të realizohet me kohë...

Eshref Vishi: Unë, e kam një çështje pak të karakterit politik...! E përmendi edhe Adnani, pra lidhur edhe me kualitetin e skanimeve të formularëve. Kemi biseduar edhe dje me Burimin, nuk e di sa është e mundur që këto skanime do të mund të shihen në ueb faqe drejt dhe mirë nga të

gjithë. Ata që kanë nevojë që këto rezultate ti shohin vetë ...A ekziston mundësia teknike, apo thjesht do të ishte ma mirë që të skanohet vetëm faqja e parë...

Illir Gashi: Kam edhe një pyetje për Burimin. Kam hasur në formularë të cilët janë të nënshkruar nga kryesuesi edhe të gjithë të tjerët, edhe nga komisionarët por, në formularë nuk konfiguroni vendvotimi, nuk është i shënuar, është i zbraztë...Kjo, prapë sjell problem te ata të cilët, faktikisht duan me bërë ankesa për ato vendvotime! Qysh ka ardhur deri te kjo, dhe a do të jetë kjo një objekt shqyrtues te rinumërimi pa ndonjë proceduar të ankimimit, apo thjeshtë është harruar që nuk është vendos numri i vendvotimit në ato fletëvotime...?

Burim Ahmetaj: Sa i përket çështjeve të flet votimeve origjinale, na nuk kemi të drejtë me ndërhy, qoftë edhe nëse nuk e kanë shënuar numrin e vendvotimit. Nuk kemi kurrfarë të drejte me ndërhy në ato formularë të rezultateve...Ne i skanojmë sipas renditjes së FPR –ve për Kryetare Komune dhe të FPR-të për Kuvendin Komunal, dhe i krahasojmë me FRK-të...E krijojmë një follder të veçantë nga secili vendvotimit, kështu që pa marr parasysh, a e kanë shënuar apo jo vendvotimin na i skanojmë ata brenda një vendvotimi dhe, gjithë këtyre artikujve u japim një emër të veçantë që lidhet me numrin e votimit. Pra, mundë ndodhë që nuk e kanë shënuar mirëpo, ne nuk kemi kurrfarë të drejte me ndërhy në formularët e rezultateve. Sa i parket skanimeve, dhe follderave... Follderat e rinumërimit, nuk kanë të bëjnë kurrgjë me vendvotimet e rregullta, ato qysh kanë ardhur vendvotimet, në atë gjendje i kemi skanuar...Ka pasur vend votime që nuk kanë pasur formularë të rezultateve, dhe ne jemi të obliguar me i skanua në atë mënyrë, në atë gjendje se qysh vijnë...Ndërsa, te rinumërimi, nëse mundeni me e pa ne ueb faqe, e kemi një follder të veçantë të rinumërimeve, pra nuk i përziejmë ne asnjë rast. Kurse, sa i përket kualitetit, jemi duke i kontrolluar të gjitha skanimet edhe njëherë dhe, aty ku është kualiteti i dobët, do ta përmirësojmë...Pra, jemi duke i kontrolluar të gjitha vendvotimet e të gjitha komunave, dhe do ta përmirësojnë shumë shpejtë kualitetin...

Valdete Daka: Kush është për, në mënyrë që të bëhet rinumërimi i këtyre 8 vendvotimeve për Kryetar Komune, dhe a janë këto të fundit...?

Burim Ahmetaj: Po, këto janë të fundit por, e bëjmë edhe një kontrollim të fundit që e krahasojmë Listën Përfundimtare të Votuesve - me nënshkrime të Formularëve të Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve. Ato, duhet me korresponduar, mirëpo ne i bëjmë dhe, të gjitha i kontrollojmë...Shpresojmë që të mos kemi rinumërimi të tjera...Por kjo ndodh vetëm në rast të mos përputhjes së nënshkrimeve të LPV-e, me nënshkrimet e FPR-ve, mirëpo besoj që numri mund të jetë shumë i vogël, dhe unë besoj se do të arrijmë te 100% dhe se nuk do të kemi nevojë për rinumërimi të reja. Pra, shanset janë shumë të vogla, është duke vazhduar edhe numërimi nga Diaspora. Në proces kanë qenë edhe 13 komuna për me u numërua...Nuk mund të them se cilat komuna janë, mirëpo unë besoj që shumë shpejt do të ju informojmë...

Valdete Daka: Kush është për këto 8 vendvotime që të rinumërohen, dhe që të procedohen si të rregullta këto 14...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e QNR –së.

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
